

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
KABINETI

URDHER

I

AKSIONISTIT TE VETEM TE SHOQERISE ANONIME  
PRODHIME FARMACEUTIKE

TIRANE

Nr.71/1 date 29.01.1996

Me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise anonime Prodhime Farmaceutike Tirane, cilesi kete qe e kam ne baze te paragrafit te dyte te nenit 3 te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995

"Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" dhe ne baze te nenit 128 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare";

*Urdheroj:*

1. Ne aktet e themelimit te shoqerise anonime Prodhime Farmaceutike Tirane te behen ndryshimet e meposhtme:

Ne kapitalin themeltar te shoqerise te shtohet vlere e truallit prej 20,400,000 leke dhe numri i aksioneve 20,400, si dhe me nje siperfaqe prej 25,500 m<sup>2</sup>. Keto ndryshime te behen ne piken 4 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 3 te Statutit te Shoqerise.

2. Vleresimi i truallit, qe do te behet shtese ne kapital sipas pikes se mesiperme, te behet sipas dispozitave ne fuqi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerive Publike te beje veprimet perkatese per shtimin e kapitalit ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te".

MINISTRI  
  
DYLBER VRIONI